



PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

07.02.2023



REPUBLIKA E KOSOVËS 02/62

KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kryesuesi i Kuvendit

Nr.02/

Datë:06.02.2023

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/15, Qershor 2008, bazuar në nenin 53 paragrafi 3, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/21, Qershor 2016", nenit 10 dhe 19, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 datë:12.11.2008,

Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 30.01.2023 merr këtë:

V E N D I M

I. Shfuqizohet, vendimin nr.02/319 të datës: 30.06.2022, për ndarjen e mjeteve financiare për klubin e futbollit FC Malisheva në Malishevë.

I I. Shfuqizimi i vendimit me numër të cekur si më lartë bëhet në pajtim me shkresën e MAPL-së nr.020-607/1 datë:12.07.2022.

I I I. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, përmes organeve kompetente.

IV. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi sipas nenit 81 të Ligjit nr.03/040, për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :

MAPL-së

Arkivit të Komunës

Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaci





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Enis Spahiu Zëvendës sekretar, MFPT	
Kopje:	Kryetari i Komunës së Malishevës Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme në MAPL	
Nga:	Besim Myrtezari, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 08.07.2022 Nr: VI-020-607
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Ardita Latifi, Zyrtare e lartë për monitorim të Komunave	
Lënda:	Kërkesë për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Malishevës	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin Nr.02/319 për ndarjen e mjeteve financiare për klubin e futbollit FC "Malisheva", i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 3, Rregullore (QRK) nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimin Nr.02/319 për ndarjen e mjeteve financiare për klubin e futbollit FC "Malisheva" i miratuar më datë: 30.06.2022

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.07.2022

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

Vendimin Nr.02/319 për ndarjen e mjeteve financiare për klubin e futbollit FC "Malisheva"
<i>I miratuar më datë 30.06.2022</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 06.07.2022</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 12.07.2022</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit përmbajtësor të aktit të mësipërm të Komunës së Malishevës, jep konstatime bazuar në këndvështrimet e mëposhtme:

1. Komuna e Malishevës, me anë të aktit administrativ që është subjekt i shqyrtimit, synon ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 100,040.00 euro për Klubin e Futbollit FC "Malisheva", të ndara në dy pjesë për periudhën dy vjeçare, në vlerë prej 50,020.00 euro për vitin 2022 dhe prej 50,020.00 euro për vitin 2023.
2. Në këtë kontekst, edhe përkundër faktit se Komunave iu jepet pavarësi financiare në menaxhimin e financave të tyre, ashtu të precizuara me nenin 2 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Komunitat obligohen t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si "LMFPP"), gjatë disponimit me të hyrat financiare komunale, e përcaktuar si në vijim:

Neni 7
Burimet Financiare Komunale

7.2 Komunitat duhet t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të LMFPP gjatë disponimit me këto burime financiare.

3. Në rrjedhë të kësaj, LMFPP konsiderohet ligj organik që përcakton kushtet, procedurat dhe konditat ligjore për menaxhimin e mirëfilltë të financave publike në përgjithësi, dhe shpenzimin e parasë publike në veçanti.

4. Në kuptim të shpenzimit të rregullt të parasë publike, neni 17 i LMFP-së precizon qartë se paratë publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike, si dhe të shpenzohen nga fondet e ndara dhe të alokuara [theks i shtuar].
5. Nisur mbi këtë bazë, Ministria ka konsultuar Ligjin Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, si dhe strukturat përgjegjëse të Ministrisë për buxhetin e Komunës së Malishevës, ku është evidentuar se momentalisht organizata buxhetore nuk ka mjete financiare të mjaftueshme për realizimin e këtij vendimi. Për qëllim të realizimit të këtij vendimi, si rekomandim, Komuna e Malishevës mund të transferojë mjetet në nën-programin si në vendim bazuar në nenin 30 të LMFP-së për rregullimin e ndarjeve buxhetore të organizatës buxhetore.
6. Si pikë e dytë, subvencionimi i organizatave jo-qeveritare rregullohet me dispozitat e Rregullores MF Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve (këtej e tutje referuar si 'Rregullorja').
7. Në këtë kuptim, Rregullorja përcakton se për t'u mundësuar subvencionimi i organizatave jo-qeveritare, organizatat buxhetore duhet t'i respektojnë kriteret si, shpallja publike e thirrjes për aplikim dhe themelimi i Komisioneve relevante për shqyrtimin e aplikacioneve (shih nenin 8, nenin 9 dhe nenin 12 të Rregullores).
8. Përfundimisht, Rregullorja ka lënë hapësirë të mos zbatimit të këtyre kriterëve për rastet e mbështetjes financiare të drejtpërdrejtë për OJQ-të, e cila mbështetje nuk tejkalon shumën prej pesëqind (500€) euro për një OJQ.
9. Marrë për bazë se vlera e përcaktuar me vendimin komunal e tejkalon vlerën prej pesëqind (500€) euro për një OJQ, dhe duke pasur në konsideratë konstatimet e dhëna në pikën 3 të këtij vlerësimi, Ministria kërkon nga Komuna e Malishevës informata dhe/apo dokumente shtesë rreth:
 - 9.1. Shpalljes së thirrjes publike dhe themelimit të Komisioneve relevante sipas Rregullores.
10. Si përfundim, Ministria kërkon nga Komuna e Malishevës që për implementim korrekt të këtij akti administrativ të marrë për bazë rekomandimet si në pikën 5, dhe të ofrojë informatat e kërkuara për procesion e përzgjedhjes së klubit të futbollit "FC Malisheva" për mbështetje financiare.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Malishevës dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.